



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

VENDIM

Nr.30, datë 30.01.2023

PËR

“PLOTËSIMIN E PESË POZICIONEVE PËR KËSHILLTAR LIGJOR PRANË
KËSHILLIT TË LARTË TË PROKURORISË, PËRMES PROCEDURËS SË
KOMANDIMIT TË PROKURORËVE”

Bazuar në nenin 149/a të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenet 53 pika 2 dhe 54 të ligjit Nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, nenet 164 pika 8, 166 pika 2, 176 pika 3, 189 pika 1, germa “a” të ligjit Nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” i ndryshuar, si dhe relacionin shpjegues të përgatitur nga Komisioni për Zhvillimin e Karrierës, Këshilli i Lartë i Prokurorisë,

V E N D O S I:

1. Të shpallë fillimin e procedurës për plotësimin e 5 (pesë) pozicioneve për Këshilltarë Ligjorë pranë Këshillit të Lartë të Prokurorisë përmes procedurës së komandimit të prokurorëve.
2. Afati i periudhës së komandimit do të jetë 5 (pesë) vjet.
3. Thirrja për pozicionet e lira në Këshillin e Lartë të Prokurorisë do të shpallet në faqen zyrtare web të Këshillit duke përcaktuar kushtet e përgjithshme, kriteret e posaçme, dokumentacionin e nevojshëm dhe afatin e shprehjes së interesit.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare web të Këshillit.
5. U shpall në Tiranë, sot më 30.01.2023.

KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

KRYETAR
Alfred Balla

ZV/KRYETAR
Tartar Bazaj

ANËTAR
Sokol Stojani

ANËTAR
Bujar Sheshi

ANËTAR
Nurihan Seiti

ANËTAR
Eloida Goxhi

ANËTAR
Esmeralda Keshi

ANËTAR
Zeqir Hoda

ANËTAR
Mirela Bogdani

ANËTAR
Arta Mandro

ANËTAR
Ledina Riza